



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:146623

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05997710

PA1.nr.933/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj, dhe Avdullah Ahmeti anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarës S.B nga fshati ...Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.281/2023, datë: 26.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **23.07.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.281/2023, datë: 26.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatë Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.13/2024, datë: 281/2023, të akuzuarën S.B, e ka shpallur fajtor për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim i cili me pëlqimin e të akuzuarës i zëvendësohet me dënim me gjobë. Të pandehurës S.B për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Konform nenit 44 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurës, dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 700.00 (shtatëqind) €. Dënimi me gjobë në bazë të nenin 43 paragrafi 2 të KPRK-së, do të paguhet në tre (3) këste mujore. Kësti i parë në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) €, të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kësti i dytë në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) € të paguhet nga data 1-5 të muajit vijues pas pagesës së kështit të parë, kësti i tretë në shumë prej 200.00 (dyqind) € të paguhet nga data 01-05 të muajit vijues pas pagesës së kështit të dytë. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan kështin me kohë. Nëse e pandehura e lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzetë euro) të dënimit me gjobë. Të dëmtuarit S.A nga fshati ..., Komuna e Vitisë dhe S.B, me vendbanim në Viti, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil. Obligohet e pandehura që të paguaj shpenzimet procedurale: paushallin gjyqësor në shumën prej 20€, për përpilimin e ekspertizës mjekoligjore shumën prej 20 (njëzet) € dhe për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave shumën prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, dhe të akuzuarës ti shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.934/2024, të dt. 19.06.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan sa i përket vendimit për sanksionin penal ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, dhe të akuzuarës ti shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPPRK-së, konstatoj se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimin i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimin i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përshkruar qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akuzuarës, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në

mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mund të kontestohet, për faktin se e akuzuara në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, dhe gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar një pohim të tillë, dhe bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga Prokuroria Themelore në Gjilan.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur as për shkak të shkelje të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga e akuzuara dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar e akuzuara, si dhe për faktin se kjo vepër për të cilën është gjykuar e akuzuara është vepër penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarës, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan që të akuzuarit shqiptohet dënim me burgim efektiv janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të akuzuarën, ka vlerësuar se e akuzuara ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e njëjta është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e saj, ka treguar kujdes, duke i vizituar të dëmtuarit gjatë trajtimit mjekësor, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurën është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh, shkallën e përgjegjësisë se të pandehurës, pasojat e shkaktuara nga vepra penale, rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale. Gjykata e Apelit këtë konstatim të Gjykatës së shkallës së parë e vlerëson si të drejtë dhe në proporcion me dënimin e shqiptuar nga e njëjta. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me burgim efektiv për të akuzuarën.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe

bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës, dhe se kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.933/2024, me datë 23.07.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Ilmije Rexhepi Beqiri

Kryetari i kolegjit

Ferit Osmani

Antarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Abdullah Ahmeti